



Prishtinë, 24 qershor 2022
Kodi i ZRRE-së: V_1517_2022

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-084);
- Nenin 8 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Nr. 05/L-085);
- Nenin 11, Nenin 12, Nenin 13, Nenin 14 dhe 17 të Ligjit për Energjinë (Nr. 05/L-081),
- Nenin 4, Nenin 5, Nenin 7, Nenin 8, Neni 9, Neni 10, Nenin 13 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, Nenin 15 paragrafi 1 dhe Nenin 16 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e kapaciteteve të reja;
- Nenin 14, Nenin 15 dhe 17 par. 5 dhe 6 të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse;
- Metodologjinë e ZRRE-së, Nr. 01/2020 për Llogaritjen e Çmimit Referent për Energjinë e Prodhuar nga BRE;
- Aplikacionin për Autorizim Final (Riaplikim) për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Uji, HC Saponica me kapacitet të instaluar prej 3.75 MW ZK Doganaj dhe Saponica, komuna e Kaçanikut, Republika e Kosovës, të datës 28.02.2022 të shoqërisë "2 Korriku" Sh.p.k., me adresë: fshati Saponicë, Komuna e Kaçanikut;
- Aplikacionin për Kornizën e Rregulluar të BRE-ve; dhe
- Vendimet, lejet dhe pëlqimet e lëshuara nga institucionet përgjegjëse, si në Shtojcën II. të këtij vendimi,

në seancën e mbajtur më 24 qershor 2022 nxori këtë:

V E N D I M
PËR LËSHIMIN E AUTORIZIMIT FINAL

- I. I lëshohet **AUTORIZIMI FINAL** shoqërisë "2 Korriku" Sh.p.k., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Uji, projekti HC Saponica me kapacitet të instaluar prej **3.75 MW**, në ngastrën kadastrave Nr. 229-2, 229-4 dhe 1399-0 ZK Doganaj dhe Saponicë, sipas **VENDIMIT PËR LEJE TË LEGALIZIMIT PËR PËRFUNDIMIN E NDËRTIMIT – 06 nr. 351/02-27108/21** të datës 30.09.2021 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Komuna e Kaçanikut, **Vendimin për Pëlqimin Mjedisor Nr. 3477/20-ZSP-/2020** të datës 21.09.2020 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (ish Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit), dhe ndryshim **Vendimin e Lejes Ujore nr. 1857/18 –ZSP1303/2018** të datës 12.10.2018 të lëshuar nga MMPH.



- II. Vendimi për Autorizim Final i lëshohet shoqërisë “2 Korriku” Sh.p.k., sipas Planit dinamik të realizimit për dy (2) vite, dhe obligohet që brenda kësaj periudhe të ndërtoj stabilimentet e reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali.
- III. ZRRE do të konsideroj projektin e finalizuar nga data e lëshimit të certifikatës së përdorimit të lëshuar nga organi kompetent sipas Ligjit për Ndërtimin.
- IV. Shoqëria “2 Korriku” Sh.p.k., do të lidh Marrëveshjen për Shitblerje të Energjisë Elektrike (MBE) me Operatorin e Transmetimit dhe Tregut (KOSTT) SH.A., e cila do të lidhet brenda tridhjetë (30) dite nga data e lëshimi të këtij vendimi të lëshuar nga Bordi i ZRRE-së.
- V. Shoqëria “2 Korriku” Sh.p.k., obligohet që para se të futet në operim (prodhim) të pajiset me Leje Mjedisore (Ekologjike) të lëshuar nga MMPH.
- VI. Shoqëria “2 Korriku” Sh.p.k., brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh para fillimit të operimit komercial të gjeneratorit sipas dispozitivit nën pikën III. dhe V. të këtij Vendimi, duhet ta njoftoj me shkrim Operatorin e Tregut, Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes dhe ZRRE-në, për datën në të cilën hyn në fuqi komerciale dhe vetëm pas nënshkrimit të Shtojcës 5 MBE, për të aktivizuar procedurën e mbledhjes dhe verifikimit të të dhënave të njehsimit (matjes).

A r s y e t i m

- o ZRRE, më 28.02.2022 nga shoqëria “2 Korriku” Sh.p.k., ka pranuar aplikacionin për marrjen e Autorizimit Final (Riaplikim) për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Uji, HC Saponica me kapacitet të instaluar prej 3.75 MW ZK Doganaj dhe Saponica, komuna e Kaçanikut, Republika e Kosovës.
- o Shoqërisë 2 KORRIKU SH.P.K., me datë 21.04.2022, ka bërë Njoftimin Publik në gazeta elektronike, ku ka njoftuar të gjitha palët e interesit se në pajtim me Nenin 10 të Rregullës së Autorizimit ka aplikuar në ZRRE pas kompletimit të dokumentacionit për marrje të autorizimit final për vazhdimin e ndërtimit të HC Saponica, me të cilën palët e interesuara janë njoftuar se vërejtje të tyre eventuale lidhur me këtë aplikacion, mund ti paraqesin në ZRRE brenda shtatë (7) ditësh nga data e publikimit. ZRRE, brenda këtij afati dhe deri në shqyrtimin e aplikacionit nga Bordi i ZRRE-në, nuk ka pranuar ndonjë vërejtje apo ankesë. Gjithashtu aplikuesi ka dorëzuar edhe pagesën e taksës së shqyrtimit të aplikacionit me datë 10.05.2022 në ZRRE.
- o ZRRE, pas analizimit të dëshmimeve të sjellura sipas Aplikacionit për Autorizim dhe vlerësimit të tyre nga ana e ZRRE-së, ka konsideruar se aplikuesi “2 Korriku” Sh.p.k., i ka plotësuar kërkesat administrative sipas aplikacionit dhe ato ligjore për tu trajtuar dhe pajisur me Autorizimin FINAL, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga UJI, HC Saponica me kapacitet të instaluar prej 3.75 MW, ZK Doganaj, komuna e Kaçanikut, sipas Lejes së legalizimit për përfundimin e Ndërtimit 06 nr. 351/02-27108/21 të datës 30.09.2021 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Komuna e Kaçanikut, Vendimin për Pëlqimin Mjedisor Nr. 3477/20-ZSP-/2020 të datës 21.09.2020 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (ish Ministria e Ekonomisë



dhe Ambientit), dhe ndryshim Vendimin e Lejes Ujore nr. 1857/18 –ZSP1303/2018 të datës 12.10.2018 të lëshuar nga MMPH.

- o Shoqëria 2 Korriku Sh.p.k., ka dorëzuar edhe kërkesën për pranin në skemën e rregulluar përmes çmimit referent.
- o Projekti i shoqërisë 2 KORRIKU SH.P.K., ka qenë i autorizuar me Autorizim Final V_880_2017 të datës 18 janar 2017, mirëpo për shkak të skadimit të afati ligjor të lejuar me Procedurën e Autorizimit për finalizimin e ndërtimit, Bordi i ZRRE-së, me Vendimin V_1421_2021 kishte refuzuar kërkesën për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së autorizimit.
- o Po ashtu shoqërisë 2 Korriku SH.P.K., me Vendimin V_1421_2021 ka pasur të drejt të ri-apikoj për marrje të autorizimit pas plotësimit të kushteve ligjore sipas dispozitave të Rregullës për procedurën e Autorizimit dhe mund t’iu nënshtrohet vetëm dispozitave ligjore të KREU III. të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse të nxjerr nga Bordi i ZRRE-së.
- o Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit të dëshmimeve të bashkangjitura dhe lejeve, pëlqimeve dhe vendimeve të lëshuara nga institucionet përgjegjëse dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

VII. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

VIII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bashkëngjitur Vendimit janë Shtojca I dhe Shtojca II.

Bordi i Rregullatorit

Ymer Fejzullahu, kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Kaçanikut,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së,
- Inspektoriatit të Mjedisit të MMPHI-së dhe
- Arkivit të ZRRE-së.



SHTOJCA I

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) duke ushtruar kompetencat e dhëna me nenin 43 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe në përputhje me Nenin 16 të Rregullës për procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja, shoqërisë "z Korriku" Sh.p.k., me adresë: fshati Soponicë, 71000 Komuna e Kaçanikut, Republika e Kosovës, më 24 qershor 2022, i lëshon këtë:

AUTORIZIM

1. Për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali, HC Soponica me kapacitet të instaluar prej 3.75 MW, në ngastrën kadastrave Nr. 229-2, 229-4 dhe 1399-0 ZK Doganaj dhe Soponicë, sipas VENDIMIT PËR LEJE TË LEGALIZIMIT PËR PËRFUNDIMIN E NDËRTIMIT – 06 nr. 351/02-27108/21 të datës 30.09.2021 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Komuna e Kaçanikut, Vendimin për Pëlqimin Mjedisor Nr. 3477/20-ZSP-/2020 të datës 21.09.2020 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (ish Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit), dhe ndryshim Vendimin e Lejes Ujore nr. 1857/18 – ZSP1303/2018 të datës 12.10.2018 të lëshuar nga MMPH.
2. Me këtë Autorizim autorizohet shoqëria "z Korriku" Sh.p.k., që të ndërtoj kapacitetet gjeneruese në lokacionin e caktuar më lart, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë Autorizim.
3. Ky Autorizim lëshohet për dy (2) vite duke filluar nga data e lëshimit të tij. ZRRE me kërkesë të palës mund ta vazhdoj vlefshmërinë e Autorizimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Pala e Autorizuar, gjatë tërë periudhës së vlefshmërisë së këtij Autorizimi, duhet të plotësojë:
 - 2.1. të gjitha kushtet e përcaktuara me këtë Autorizim, dhe
 - 2.2. të gjitha kushtet e përcaktuara me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës, përfshirë edhe ato për mjedisin.
5. Në rast se pala e Autorizuar falimenton para se të ndërtohet stabilimenti gjenerues i autorizuar, atëherë ky Autorizim do të pezullohet dhe do të mbetet i tillë derisa ZRRE përcakton se janë arritur kushtet për tërheqjen e pezullimit. Derisa ky Autorizim është i pezulluar e tërë puna e mëtutjeshme në ndërtimin e stabilimentit gjenerues të autorizuar duhet të ndërpritet. Në rast të kundërt, ndaj palës së Autorizuar mund të ndërmerren masat administrative dhe gjobat të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
6. Vlefshmëria e këtij Autorizimi automatikisht do të përfundoj me skadimin e afatit të përcaktuar në dispozitivin nën II. të këtij Vendimi, apo me skadimin e afatit shtesë të përcaktuara nga ZRRE në përputhje me pikën 3 të shtojcës I. të këtij Autorizimi.
7. Në rast se pala e Autorizuar bën shkeljen e ndonjërit prej kushteve të këtij Autorizimi dhe të dispozitave ligjore në fuqi, ZRRE do të pezulloj këtë Autorizim në përputhje me dispozitat e Rregullës për procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja. Nga data e pezullimit të Autorizimit e tërë puna e mëtutjeshme në stabilimentin e autorizuar do të ndërpritet. Në rast të mos respektimit të kushteve ligjore, ndaj palës së Autorizuar mund të ndërmerren masat administrative dhe gjobat të përcaktuara sipas legjislacionin në fuqi.



SHTOJCA II

Lista e dokumenteve (lejeve, pëlqimeve, vendimeve etj.) të lëshuar nga institucionet e Republikës së Kosovës lidhur me marrjen e **Autorizimin Final për Ndërtim** të shoqërisë "2 Korriku" Sh.p.k., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga UJI HC Soponica – ZK Doganaj, me kapacitet të instaluar prej **3.75 MW**, komuna e Kaçanikut:

- **Njoftimi** Nr. 06-104/02-35113/19 të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Komuna e Kaçanikut.
- **Pëlqimi** Nr. 06-350/01-4745/20 i datës 29.04.2020 të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Komuna e Kaçanikut.
- **Pëlqimi** Nr. 01/2021 i datës 02.02.2021 i lëshuar nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent, Ministria e Punëve të Brendshme.
- **Pëlqimi Elektroenergjetik** nr. 513, dt. 25.01.2022 i lëshuar nga KEDS SH.A;
- **Pëlqimin Mjedisor** - nr. 4268-2/20 i datës 29.01.2021 i lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) –Zyra e Sekretarit Permanent (ZSP);
- **Vendimi** Nr. 3477-2/20 i datës 21.09.2020 për themelimin e servitutit të instalimit të tubacionit nëntokësor të HC-ës, në pasuri publike ujore, të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) –Zyra e Sekretarit Permanent (ZSP);
- **Ndryshimi i Vendimit për Leje Ujore** me nr. 1857/18-ZSP-1303/2018 të datës 17.09.2018 për HC Soponica, nga N=1.3 MW në N=3.75 MW të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) –Zyra e Sekretarit Permanent (ZSP);
- **Pëlqimi Ujor** – nr. 1167-2/16 ZSP 579/2016 i datës 25.05.2016 i lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) –Zyra e Sekretarit Permanent (ZSP);
- **VENDIMIN PËR LEJA TË LEGALIZIMIT PËR PËRFUNDIMIN E NDËRTIMIT** – 06 nr. 351/02-27108/21 të datës 30.09.2021 për Lejimin e përfundimit të ndërtimit të hidrocentralit në lumit Lepenc HC Soponica me kapacitet të instaluar prej 3.75 MW, në ngastrën kadastrave Nr. 229-2, 229-4 dhe 1399-0 ZK Doganaj dhe Soponicë, e lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Komuna e Kaçanikut.
- **Certifikatat e ngastrës kadastrale.**
- **Studimi i Fizibilitetit teknik, mjedisor dhe financiar.**
- **Plani i Biznesit.**
- **Projekti kryesor.**